


Efektet e Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar

Nëntor 2016



1. Hyrje

Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) është burimi kryesor i të hyrave tatimore në Kosovë. Në vitin 2015, TVSH përbënte rreth 47% të të hyrave nga tatimet.¹ Në mars të vitit 2015, Qeveria e Kosovës e gjendur përballë një rritje të pritshme të deficitit buxhetor, si pasojë e rritjes së pagave në sektorin publik dhe shpenzimeve për autostradën Prishtinë-Shkup, detyrohet që të bëjë një varg ndryshimesh në tatime dhe akciza.² Vendimi i cili do të kishte potencialisht efektin më të madh tek të hyrat buxhetore, aktivitetin biznesor dhe çmimet e konsumit ishte aprovimi i Ligjit të ri për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Më anë të këtij ligji, ndër të tjera, Qeveria e Kosovës ngriti shkallën e TVSH-së nga 16% në 18% në shumicën e produkteve, ndërsa uli TVSH-në nga 16% në 8% kryesisht në produkte ushqimore.

Qeveria e Kosovës miratoi edhe një sërë ndryshimesh tjera që kanë të bëjnë me politikat fiskale, siç janë: Projektligji për tatimin në të ardhurat e korporatave, Projektligji për tatimin në të ardhurat personale, ndryshimi i shkallës së akcizës në vetura, cigare, pije alkoolike, vajra etj.³

Përmes kësaj analize, Instituti GAP synon që të mat efektet e Ligjit për TVSH një vit pas hyrjes së tij në fuqi. Pjesa e parë e analizës përmban një përmbledhje të ndryshimeve kryesore në Ligjin e ri për TVSH⁴. Pjesa e dytë përmban një analizë të efekteve të reduktimit të shkallës së TVSH-së nga 16% në 8% në të hyrat doganore, të hyrat vendore dhe çmimet e konsumit. Në mënyrë që të masim efektin e uljes së TVSH-së në të hyrat doganore, nga databaza e Doganës së Kosovës janë izoluar vetëm ato kode tarifore në të cilat me udhëzimin administrativ është aplikuar TVSH e reduktuar.⁵ Në kuadër të pjesës së dytë analizohen edhe efektet e aplikimit të TVSH-së prej 8% në barna. Pjesa e tretë analizon efektin në të hyrat buxhetore si pasojë e rritjes së shkallës standarde të TVSH-së nga 16% në 18%. Në këtë pjesë janë analizuar efektet në të hyrat doganore në produktet në të cilat është aplikuar shkalla standarde e TVSH-së prej 18%. E njëjta analizë nuk ka mundur të aplikohet për të hyrat e ATK-së, për shkak të mungesës së një databaze e cila jep informata për të hyrat në nivel të secilës kategori produktesh. Pjesa e katërt analizon disa prej ndryshimeve në Ligjin për TVSH të cilat kanë prekur bizneset si: largimi i TVSH-së në lëndën e parë, makineri

¹ Ministria e Financave, Raporti Vjetor Financiar, Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2015, Burimi: <http://bit.ly/28YehHp>

² Fondi Monetar Ndërkombëtar, Kosovo: Concluding Statement of the 2015 Article IV Mission, 30 Mars 2015, Burimi: <http://bit.ly/1FccDJt>

³ Qeveria e Republikës së Kosovës, Vendimi nr. 02/20, Vendimi 03/20 dhe 04/20, 24 Mars 2015, Burimi: <http://bit.ly/1bdmMy>

⁴ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.05/L-037 për tatimin mbi vlerën e shtuar. Publikuar më 17.08.2015. Burimi: <http://bit.ly/2f0ErfI>

⁵ Udhëzim Administrativë nr. 03/2015 për zbatimin e ligjit nr.05/ I-037 për tatimin mbi vlerën e shtuar, Burimi: <http://bit.ly/2d2rPak>

dhe teknologji informative (TI), ulja e pragut për regjistrim në TVSH, çështjet e rimbursimit etj. Në këtë analizë, përveç të dhënave të ATK-së, Doganës, Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), janë marrë edhe vlerësimet e përfaqësuesve të bizneseve dhe profesionistëve të fushës së taksave.

2. Ndryshimet në Ligjin për TVSH

Ligji i ri për tatimin mbi vlerën e shtuar hyri në fuqi më 1 shtator 2015. Sipas Ministrit të Financave, z.Avdullah Hoti, ky ligj ishte pjesë e pakos fiskale e cila ka për qëllim "të nxisë punësimin, por gjithashtu të rrisë edhe mirëqenien e qytetarëve, të përmirësojë bilancin tregtar të Kosovës dhe disa objektiva të tjera."⁶

Disa nga ndryshimet kryesore të këtij ligji janë:

- Shkalla standarde e TVSH-së është rritur nga 16% sa ka qenë në ligjin e kaluar në 18%. Ky ndryshim shënon një rritje në shkallën e TVSH-së prej 12.5% apo dy pikë përqindje.
- Qeveria e Kosovës ka aplikuar shkallë të reduktuar të TVSH-së prej 8% në disa produkte dhe shërbime. Disa nga këto produkte dhe shërbime përfshijnë: shërbimet publike (rrymë, ujë të pijshëm, mbledhje të mbeturinave, ngrohtore), drithërat, mielli, vajrat, qumështi, kripa për konsum njerëzor, librat shkollorë, pajisjet e teknologjisë së informacionit, barnat, pajisjet mjekësore, etj. Para hyrjes së ligjit në fuqi, TVSH në barna ishte 0%.
- Pragu i regjistrimit dhe metoda e kalkulimit për regjistrim të bizneseve për TVSH ka ndryshuar. Para hyrjes në fuqi, bizneset të cilat kanë realizuar qarkullim më shumë se 50,000 euro brenda vitit kalendarik kanë qenë të detyruara të regjistrohen për certifikatë të TVSH-së. Me ligjin e ri, duhet të regjistrohen për TVSH të gjitha ato biznese të cilat brenda vitit kalendarik tejkalojnë 30,000 euro qarkullim.
- Me aprovim nga ATK, lirohen nga TVSH linjat e prodhimit dhe makineritë për përdorim në procesin e prodhimit, lënda e parë që shfrytëzohet për procesin e prodhimit, pajisjet e teknologjisë së informacionit.⁷

⁶ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Transkripti i mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës i mbajtur me 28 maj 2015, Burimi: <http://bit.ly/1HJ4VfS>

⁷ Gazeta Zyrtare, Ligji nr. 05/L-037 për tatimin mbi vlerën e shtuar, Neni 29: Burimi: <http://bit.ly/2e6Jl9w>

- Gazetat, botimet periodike, pajisjet dhe materialet e importuara për nevojat e medieve të shkruara dhe elektronike lirohen automatikisht nga TVSH.

3. Efektet e Shkallës së Reduktuar të TVSH-së

Siç u përmend më lartë, Ligji i ri për TVSH për herë të parë ka reduktuar normën e TVSH-së në disa produkte. Përderisa ky ligj rregullon vetëm kategoritë e produkteve në të cilat mund të aplikohet TVSH e reduktuar prej 8%, kodet tarifore të produkteve me TVSH të reduktuar janë të precizuara me udhëzim administrativ.⁸ Sipas ligjit, Ministri i Financave mund të zgjerojë listën e produkteve brenda këtyre kategorive, pa marrë ndonjë miratim nga Kuvendi i Kosovës.⁹

Në mënyrë që të masim efektin e uljes së TVSH-së në të hyrat doganore kemi analizuar databazën e Doganës së Kosovës lidhur me të hyrat në nivel të kodeve tarifore. Tabela 1 përmban të hyrat doganore të mbledhura në dogana vetëm për ato kode tarifore të cilat sipas Udhëzimit administrativ nr.03/2015 aplikohet TVSH e reduktuar prej 8%. Siç e shohim nga Tabela 1, megjithëse nga shtatori 2015, TVSH në këto produkte është zbritur për 50% (nga 16% në 8%), të hyrat e mbledhura nga TVSH janë rritur për rreth 1 milionë euro (14%). Arsye për këtë rritje është rritja e nivelit të importit në këto produkte dhe aplikimi i shkallës prej 8% të TVSH në barna. Para hyrjes në fuqi të ligjit të ri për TVSH, TVSH në barna ka qenë 0%.

Tabela 1. Të hyrat e mbledhura në dogana nga produktet me 8% TVSH

	TVSH		Taksa doganore		Total	
	Janar-gusht 2015	Janar-Gusht 2016	Janar-gusht 2015	Janar-Gusht 2016	Janar-gusht 2015	Janar-Gusht 2016
Të hyrat pa barna	€7,442,080	€ 6,115,075	€ 1,676,912	€ 2,453,748	€ 9,118,992	€ 8,568,823
Barnat		€ 2,359,675	€ 2,143,542		€ 2,143,542	€ 2,359,675
Total	€ 7,442,080	€ 8,474,750	€ 3,820,454	€ 2,453,748	€ 1,262,534	€ 10,928,498

Burimi: Dogana e Kosovës


Duke marrë për bazë shumën mbi të cilën është aplikuar TVSH prej 8% nga të hyrat doganore, figura 1 paraqet një skenar se sa do të ishin të hyrat doganore në periudhën janar-gusht 2016 në rast se në produktet me TVSH të reduktuar, do të zbatohesh shkalla standarde e TVSH-së prej 18%. Në bazë të kalkulimeve për periudhën janar-gusht 2016 të hyrat e mbledhura nga dogana në këto produkte do të ishin rreth 19.1 milionë

⁸ Udhëzim Administrativë nr. 03/2015 për zbatimin e ligjit nr.05/ I-037 për tatimin mbi vlerën e shtuar. Burimi: <http://bit.ly/2d2rPak>

⁹ Gazeta Zyrtare, Ligji nr. 05-037 për tatimin mbi vlerën e shtuar, Neni 26.3

euro apo rreth 10.6 milionë euro më të larta së të hyrat aktuale. Me fjalë tjera, përderisa në mesatare të hyrat e mbledhura nga këto produkte në periudhën janar-gusht 2016 kanë qenë rreth 1.1 milionë euro në muaj, me TVSH prej 18% do të ishin 2.4 milionë euro.

Figura 1 Të hyrat nga TVSH e mbledhur në dogana pa përshkallëzim të TVSH-së



Burimi: Dogana e Kosovës

Ulja e TVSH-së në disa produkte ka ndikuar edhe tek të hyrat e ATK-së apo të hyrat vendore. Siç shihet në tabelën 2, në periudhën janar-qershor 2015-2016 të hyrat e ATK-së janë ulur për rreth 11.6 milionë euro. Në rast se kjo tabelë do të përmbante të hyrat e mbledhura nga barnat, atëherë rënia nga mbledhja e TVSH-së do të ishte më e vogël.

Në bazë të një kalkulimi të përafërt, në rast se në këto produkte/shërbime do të aplikohesh TVSH-ja standarde prej 18%, na del se në periudhën janar-qershor 2016 ATK do të mblidhte rreth 7.5 milionë euro më shumë të hyra (në total rreth 13.5 milionë euro) krahasuar me të hyrat aktuale.

Tabela 2. Ndikimi i uljes së TVSH-së në të hyrat e ATK-së

Aktivitetet	Pagesat Janar-Qershor 2015 (€)	Pagesat Janar-Qershor 2016 (€)	Diferenca e pagesave (€)
1	2	3	4=3-2
Prodhimi i energjisë elektrike	8,828,229	€ 3,987,812	(4,840,417)
Tregtia e energjisë elektrike	4,987,075	€ 1,062,883	(3,924,192)
Prodhimi i produkteve të qumështit	565,456	€ 194,323	(371,133)
Grumbullimin, trajtimin dhe furnizimin me ujë	834,954	214,062	(620,892)
Aktivitetet e kompanive "holding"	270,373	158,196	(112,177)
Tregtia me shumicë e produkteve të qumështit, vezëve, vajrave dhe yndyrave të gatimit	219,450	153,545	(65,905)
Prodhimi i bukës, simiteve dhe ëmbëlsirave të freskëta	118,036	84,622	(33,414)

Aktivite shërbimi të mirëmbajtjes dhe kujdesit të shesheve (mjedisit)	272,760	81,825	(190,935)
Prodhimi i fshesave dhe furçave	327,004	21,841	(305,164)
Furnizimi me avull dhe ajër të kondicionuar	84	27	(57)
Transporti tjetër rrugor i pasagjerëve p.k.t.	28,468	7,279	(21,188)
Shërbimet funerale dhe aktivitetet e lidhura me to	74,528	3,082	(71,446)
Prodhimi i makaronave, shpagetave dhe produkteve të ngjashme nga mielli	€ 14,479	3,016	(11,462)
Prodhimi i kompjuterëve dhe pajisjeve periferike	€ 6,692	2,740	(3,952)
Tregtia me shumicë e kompjuterëve, e pajisjeve periferike të kompjuterëve dhe softuerëve	€ 1,712	6,102	4,390
Shpërndarja e energjisë elektrike	€ 1,014,984	-	(1,014,984)
Gjithsej	€ 17,564,285	5,981,356	(11,582,929)

Burimi: ATK

Sa i përket efektit të TVSH-së së reduktuar në çmimet e konsumit, duke marrë parasysh se ekonomia e Kosovës funksionon mbi parimet e tregut, shteti nuk mund t'i ndikojë drejtpërdrejtë çmimet e konsumit me anë të uljes së TVSH-së. Sa i përket efektit të uljes së TVSH si instrument për rishpërndarjen e të ardhurave, të gjeturat tregojnë se ulja e TVSH-së nuk është një instrument efektiv për të arritur këtë qëllim.¹⁰ Ndikimin e ulët të TVSH-së në çmimet e konsumit mund ta vërejmë nëse krahasojmë çmimet e muajit shtator me muajin paraprak në disa prej produkteve në të cilat është aplikuar TVSH e reduktuar. Të dhënat në Tabelën 3 sugjerojnë se nuk ka pasur zbritje të çmimeve në të gjitha produktet me TVSH të reduktuar. Gjithashtu, ulja e çmimeve tek disa produkte në muajin shtator nuk ka rezultuar e qëndrueshme deri në fund të vitit. Duke marrë parasysh nivelin e lartë të importit, çmimet e konsumit në Kosovë më shumë ndikohen nga çmimet e tregjeve ndërkombëtare, se sa nga faktorë të brendshëm ekonomik apo social.¹¹

Tabela 3. Indeksi i çmimeve të konsumit në produktet në të cilat është zbritur TVSH-ja

	Shtator 2015 - Gusht 2015	Dhjetor 2015 - Dhjetor 2014	Ø2015/Ø2014
Buka dhe drithërat	-1.9	-0.2	0.6
Qumështi, djathi dhe vezët	2	-1.7	-2.9
Furnizimi me ujë dhe shërbimet e ndryshme që kanë të bëjnë me vendbanimin	-6.3	-5	-1
Rryma, gazi dhe lëndë djegëse të tjera	-3.4	-2.5	3
Vajrat dhe yndyrat	-0.3	6	2.3
Pajisjet audio-vizuele, fotografike për përpunimin e informatave	-0.1	0	-1

¹⁰ Grupi për Studime Politike dhe Juridike, An assessment of the VAT policy in Kosovo: its potential impact on consumers and businesses, Burimi: <http://bit.ly/2dpSJFh>

¹¹ Banka Qendrore e Kosovës, Raporti i Stabilitetit Financiar Nr. 09, Korrik 2016, faqe 28, Burimi: <http://bit.ly/2dD46fR>

Burimi: ASK

Gjatë hulumtimit tonë për aplikimin e normës së reduktuar të TVSH-së, kemi hasur një rast kur operatorë të ndryshëm ekonomikë kanë aplikuar norma të ndryshme të TVSH-së për të njëjtin produkt. Aplikimi i normave të ndryshme të TVSH-së për të njëjtin produkt është e jashtëligjshme, dëmton konkurrencën mes bizneseve dhe ul të hyrat buxhetore.

Përveç produkteve ushqimore, në listën e produkteve me TVSH të reduktuar janë futur edhe disa nga pajisjet e TI-së (siç janë: lap-top, tabletë, kompjuter). Ulja e TVSH-së iu mundëson shitësve të TI-së dhe konsumatorëve që të shesin, respektivisht blejnë, produkte të TI-së me çmime më konkurruese krahasuar me Maqedoninë ngase në Maqedoni TVSH në pajisje të TI është 5%.¹² Përfaqësues të shoqatës për teknologji informative kanë kërkuar që kjo listë të zgjerohet për arsye se një numër produktesh me rëndësi (p.sh. printerë) nuk janë përfshirë në këtë listë.¹³ Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, importi i pajisjeve të TI nga kapitulli 8471 (ku bëjnë pjesë llap-topët, kompjuterët, tabletat etj.) i Tarifës së Integruar të Kosovës (TARIK),¹⁴ është rritur për 62% (nga 5,6 milionë euro për periudhën janar – gusht 2015 në 9,1 milionë euro për periudhën janar – gusht 2016).

3.1 Ndikimi i TVSH në çmimet e barnave

Siç u përmend më lartë, nga shtatori i vitit 2015 ka filluar zbatimi i TVSH-së prej 8% në barna, nga zero sa ishte para shtatorit 2015. Në fund të po atij muaji, Qeveria e Kosovës mori vendim që në kuadër të mallrave të liruara nga tatimi doganor, të futeshin edhe barnat në kuadër të kapitullit 30 të TARIK.¹⁵

Të hyrat doganore të mbledhura nga barnat në periudhën janar-gusht 2016 nga vendosja e TVSH-së kanë qenë rreth 2.4 milionë euro, apo rreth 216 mijë euro (10%) më të larta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Nëse marrim mesataren mujore, në periudhën janar-gusht 2015, Dogana ka mbledhur mesatarisht rreth 268 mijë euro nga taksa doganore, ndërsa në periudhën janar-gusht 2016, janë mbledhur mesatarisht rreth 295 mijë euro në muaj TVSH.

¹² ICT Sector in the Republic of Macedonia, <http://bit.ly/2e5sZNK>, faqe 23

¹³ Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës, Intervistë me Vjollca Çavollin- Drejtoreshë Ekzekutive, 10 tetor 2016

¹⁴ Kapitulli 8471 përmban makinat e përpunimit automatik të të dhënave dhe njësitë e tyre; lexuesit magnetikë ose optikë, makinat për kopjimin e të dhënave në ose drejt një mjedisi të dhënash në formë të koduar dhe makinat për përpunimin e të dhënave të tilla, jo të specifikuara ose përfshira diku tjetër

¹⁵ Udhëzim administrativ, QRK- NR.05/ 2015 për mallrat e liruara nga tatimi doganor, Burimi: <http://bit.ly/2dLWFB4>

Tabela 4. Të hyrat doganore nga kapitulli 30 (barnat)

Janar-gusht 2015	Janar-gusht 2016
€ 2,143,542	€ 2,359,675

Burimi: Dogana e Kosovës

Vendosja e TVSH-së prej 8%, krahasuar me largimin e taksës në import prej 10%, do të duhej t'i ulte të hyrat, mirëpo rritja e të hyrave ka ndodhur për shkak se rreth 12% e barnave importohen nga shtetet e CEFTA-s, shtete të cilat kanë qenë të liruara nga taksa doganore dhe për shkak të një rritje të lehtë në import.¹⁶

Vendosja e TVSH-së dhe largimi i taksës në import, potencialisht i ka shtrenjtuar barnat e prodhuara në vend krahasuar me importet e barnave jashtë vendeve të CEFTA-s. Në bazë të të dhënave të ASK-së, çmimet e konsumit për prodhimet dhe pajisjet mjekësore në muajin shtator të vitit 2015 janë rritur për 2.4%, krahasuar me një muaj më parë apo 3.2% krahasuar me shtatorin e vitit të kaluar. Në fund të vitit 2015, indeksi i çmimit për këto produkte është rritur për 1.7%.¹⁷

Megjithëse TVSH ka mundur të ndikojë në ngritjen e çmimeve të barnave të prodhuara në Kosovë, prodhuesi më i madh në vend i barnave i përkrah ndryshimet në ligjin për TVSH. Dy arsytet pse ky ligj është parë më i favorshëm nga prodhuesi vendor janë: a) kompanisë i është mundësuar riimbursimi i TVSH-së nga investimi në objekt, makineri etj.; b) kompania ka përfituar nga lirimi i TVSH-së në lëndën e parë. Riimbursimi i ka mundësuar kompanisë që të ulë koston e investimit fillestar, ndërsa lirimi nga TVSH i lëndës së parë i ka mundësuar që të rrisë stokun për 16%. Kjo e fundit e ka përmirësuar likuiditetin dhe efikasitetin brenda kompanisë, që gjithashtu kanë efekte në uljen e koston së prodhimit.¹⁸

4. Efektet e shkallës së rritur të TVSH-së

Pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri për TVSH, shkalla standarde e TVSH-së në shumicën e produkteve është rritur nga 16% në 18%, apo 12.5% më e lartë se para shtatorit të vitit 2015. Në bazë të kodeve tarifore të produkteve të importuara në vitin 2015, TVSH e zbritur është aplikuar në rreth 300 kode doganore, ndërsa në rreth 5,500 kode tjera tarifore është vendosur TVSH prej 18%. Siç është pritur, rritja e TVSH-së së

¹⁶ CEFTA është krijuar me qëllim të eliminimit të pengesave për tregtinë reciproke mes shteteve anëtare. Më shumë informata rreth kësaj marrëveshje mund të gjenden në faqen e internetit <http://cefta.int/>

¹⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Indeksi i Harmonizuar i çmimeve të konsumit, shtator 2015, Burimi: <http://bit.ly/1bsMxTf>

¹⁸ Trepharm, Intervistë me Mërgim Prishtinën -Drejtor ekzekutiv, 21 shtator 2016.

bashku me rritjen e nivelit të importit, ka reflektuar pozitivisht tek të hyrat doganore. Përderisa në periudhën janar-gusht 2015 Dogana e Kosovës ka mbledhur rreth 250.7 milionë euro nga produktet në të cilat është aplikuar TVSH-ja standarde (18%), në periudhën e njëjtë të vitit 2016 janë mbledhur 318.5 milionë euro apo rreth 68 milionë euro (27%) më shumë së në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.


Tabela 4. Të hyrat nga shkalla standarde e TVSH-së

	Të hyrat nga shkalla standarde e TVSH-së
Janar-gusht 2015 (TVSH = 16%)	€ 250,713,225
Janar-gusht 2016 (TVSH = 18%)	€ 318,493,702

Burimi: Dogana e Kosovës

Në mënyrë që të masim efektin e ngritjes së TVSH-së nga 16% në 18%, duke marrë për bazë shumën e importit mbi të cilën është vendosur TVSH standarde prej 18% gjatë periudhës shtator-gusht 2015/2016, kemi aplikuar normën e TVSH-së prej 16%. Në bazë të kësaj shohim se të hyrat doganore janë rritur mesatarisht rreth 4.5 milionë euro në muaj si pasojë e rritjes së normës së TVSH-së. Në periudhën janar-gusht 2016, krahasuar me vitin e kaluar të hyrat e doganës vetëm nga rritja e TVSH-së janë rritur për rreth 35.4 milionë euro.

Figura 2 Rritja e të hyrave doganore nga rritja e shkallës së TVSH-së



Burimi: Dogana e Kosovës dhe kalkulimet e Institutit GAP

Rritja e TVSH-së ka ndikuar pozitivisht edhe tek të hyrat e ATK-së. Në periudhën shtator-dhjetor 2015, ATK ka grumbulluar rreth 6.5 milionë euro më shumë TVSH nga produktet/shërbimet në të cilat TVSH është rritur.¹⁹ Nëse marrim si mesatare mujore, atëherë i bie që të hyrat e ATK-së janë rritur mesatarisht rreth 1.6 milionë euro në muaj për këtë periudhë.

¹⁹ ATK, Përgjigje me email, 27 shtator 2016

Tabela 5. Të hyrat e ATK-së

Shtator-Dhjetor 2014	Shtator-Dhjetor 2015	Diferenca
1	2	3=2-1
€ 41,162,519	€ 47,684,620	€ 6,522,101

Burimi: ATK

5. Ndryshimet tjera

Lirimet nga TVSH. Siç u përmend më lartë, me aprovim nga ATK lirohen nga TVSH linjat e prodhimit dhe makineritë për përdorim në procesin e prodhimit, lënda e parë që shfrytëzohet për procesin e prodhimit dhe pajisjet e teknologjisë së informacionit (TI). Të drejtën për lirim të TVSH-së në lëndën e parë e kanë vetëm prodhuesit vendor, ndërsa në lirimet në teknologji vetëm bizneset që zhvillojnë aktivitete në fushën e teknologjisë informative apo merren me rishitje të TI-së. Për lirime, bizneset duhet të aplikojnë në ATK.

Numri i bizneseve të cilat kanë aplikuar për lirime në lëndën e parë nga TVSH në periudhën dhjetor 2015 deri në shtator të vitit 2016 është gjithsej 183, ndërsa numri i lëndëve të aprovuara 242.²⁰ Vlera e importit të lëndës së parë të liruar nga dogana në periudhën janar-gusht 2016 është rreth 62.3 milionë euro apo 10.2 milionë euro ngarkesë e TVSH-së. Sa i përket pajisjeve të teknologjisë informative, 11 biznese janë liruar nga TVSH, ndërsa vlera e importit të liruar nga TVSH në dogana është 1 milionë euro.²¹

Tabela 6. Lirimet nga TVSH nga Dogana e Kosovës janar-gusht 2016

Përshkrimi	Vlera e importit (€)	Lirim nga TVSH (€)
Linjat dhe makineritë e prodhimit	26,266,520	4,669,547
Lënda e parë për prodhim	62,455,649	10,191,187
Lirim qarkullim të lirë për prodhim	1,543,009	305,394
Pajisje të teknologjisë së informacionit	1,028,784	86,102
Gjithsej	91,293,962	15,252,230

Burimi: Dogana e Kosovës

Lirimi i këtyre produkteve nga TVSH nuk paraqet humbje për buxhetin, sepse në të kaluarën kjo shumë i'u është rimbursuar bizneseve. Mirëpo, tashmë bizneset nuk kanë nevojë të presin për riimbursim të TVSH-së deri sa të realizojnë shitjen e produkteve të tyre. Kjo e rrit likuiditetin e bizneseve kosovare dhe gjithashtu mund të ketë efekte në rritje të efijencës. Kjo, ngase bizneset janë në gjendje të sigurojnë sasi më të madhe të lëndës së parë në stok. Në mungesë të të dhënave të detajuara financiare për bizneset që kanë përfituar nga lirimet nga

²⁰ ATK, Lista e t/p që u janë aprovuar Lirimet e TVSH në importim të mallrave të liruar nga TVSH, Lënda e parë, Burimi: <http://bit.ly/2dGMXzq>

²¹ ATK, Lista e t/p që u janë aprovuar Lirimet e TVSH në importim të mallrave të liruar nga TVSH, Pajisje të teknologjisë informative, Burimi : <http://bit.ly/2dFCS4Y>

TVSH, është vështirë të maten efektet në efikasitet apo kosto të bizneseve. Në bazë të të dhënave të ATK-së, qarkullimi i bizneseve që kanë përfituar nga lirimet në TVSH është rritur rreth 5%.²²

Kërkesë tjetër e bizneseve sa i përket politikave fiskale që ndikojnë në kosto të prodhimit është largimi i taksës doganore në lëndën e parë dhe paraqitja e pushimeve tatimore për investimet e reja. Së fundmi, Qeveria e Kosovës ka liruar nga taksa doganore naftën e koksit që përdoret si lëndë e parë sidomos nga prodhuesit e materialit ndërtimor.²³

Ulja e pragut të regjistrimit. Me qëllim të uljes së informalitetit dhe përfshirjes të sa më shumë bizneseve në kuadër të TVSH-së, në ligjin në fuqi për TVSH është ulur pragu i regjistrimit të bizneseve për TVSH. Në ligjin e kaluar, nëse një biznes ka realizuar furnizime më pak së 50,000 euro brenda një viti kalendarik, atëherë ka qenë i liruar nga regjistrimi për TVSH.²⁴ Me ligjin e ri, një biznes duhet të regjistrohet për TVSH nëse tejkalon qarkullimin mbi 30,000 euro, ndërsa pjesa e qarkullimit e cila tejkalon këtë shumë do të tatóhet për qëllime të TVSH-së.²⁵ Me hyrjen në fuqi të ligjit, numri i bizneseve të regjistruara për TVSH është rritur dukshëm. Para hyrjes së ligjit në fuqi, mesatarja mujore e bizneseve të reja të regjistruara për TVSH ka qenë 163, ndërsa pas hyrjes kjo mesatare është rritur në 326.

Megjithëse ulja e pragut të regjistrimit për TVSH mund të rris burokracinë për bizneset e vogla, ky ndryshim është përkrahur nga përfaqësuesit e bizneseve për arsye se ul informalitetin, duke qenë se më shumë biznese përfshihen në kuadër të deklarimit të TVSH-së.²⁶ Në anën tjetër, ulja e pragut të regjistrimit për TVSH paraqet nevojë për rritje të numrit të inspektorëve të ATK-së, ngase siç u cek më lartë është rritur numri i bizneseve të regjistruara, dhe se tash këto biznese duhet të inspektohen nëse po i përmbahen deklarimit.²⁷ Megjithëse numri i bizneseve të regjistruara është rritur, numri i inspektorëve tatimor në ATK është ulur për pesë në vitin 2015 (nga 291 në 286).²⁸ Përveç numrit të inspektorëve, ATK duhet të investojë në rritjen e profesionalizimit të tyre.²⁹

Rimbursimi. Me udhëzimin e ri administrativ, nëse sipas vlerësimit të ATK-së, një biznes e mbidekalon kërkesën për rimbursim të TVSH-së, atëherë i njëjti detyrohet që të parashtrojë një kërkesë të re apo

²² ATK, Përgjigje me email 27 shtator 2016

²³ Qeveria e Kosovës, Vendimi nr. 04/109, Burimi: <http://bit.ly/2dgrvEE>

²⁴ Gazeta Zyrtare, Ligji nr. 03/L-147 për tatimin mbi vlerën e shtuar, Neni 6.1

²⁵ Gazeta Zyrtare, Ligji nr. 05/L-037 për tatimin mbi vlerën e shtuar, Neni 6.1

²⁶ Oda Ekonomike Amerikane, Intervistë me Visar Hapciun, 22 shtator 2016

²⁷ Deloitte Kosovë, Intervistë me Ruzhdi Zenelaj- Menaxher i taksave, 27 shtator 2016

²⁸ ATK, Raporti i punës janar-dhjetor 2015, Burimi: <http://bit.ly/2dh7YAt>

²⁹ Deloitte Kosovë, Intervistë me Ruzhdi Zenelaj- Menaxher i taksave, 27 shtator 2016

kërkesën për kreditimin ta bartë për periudhat vijuese.³⁰ Kjo paraqet kërkesë shtesë me atë se çka është rregulluar me ligj. Gjithashtu, ky kufizim paraqet problem për bizneset për arsye se procedura e rimbursimit mund të tejzgjatet. Kërkesa për rimbursim mund të merr shumë kohë për shqyrtim për shkak të shqyrtimit prej zyrtarëve rajonal dhe qendror të ATK-së. Së fundmi, problem për bizneset paraqet edhe fakti se një pagesë duhet të kryhet në periudhën e njëjtë të faturimit në mënyrë që të kërkohet rimbursim.³¹ Për arsye të kohës së shkurtër që kanë pas në dispozicion për komente, pakënaqësi lidhur me hartimin e këtij udhëzimi administrativ kanë shprehur edhe përfaqësuesit e bizneseve.³²

Transaksionet financiare. Ligji për TVSH liron nga TVSH transaksionet financiare si dhënia e kredisë apo aktivitetet në menaxhimin e fondeve investuese pa ndonjë kufizim se nga çfarë institucioni kryhen ato.³³ Në udhëzimin administrativ, lirimi i TVSH-së në këto aktivitete është liruar vetëm nëse ato kryhen nga një institucion financiar.³⁴ Sikur me rastin e rimbursimit, udhëzimi administrativ paraqet kushte përtej kërkesave të ligjit. Ky kufizim paraqet probleme për degët e kompanive në rastet kur ato marrin kredi nga institucionet amë dhe nuk janë institucione financiare, sepse obligohen të paguajnë TVSH.³⁵ Kjo përveç se e rrit koston e financimit për biznese, krijon kushte më të favorshme për institucionet financiare krahasuar me bizneset tjera jo-financiare.

³⁰ Udhëzim Administrativë nr. 03/2015 për zbatimin e ligjit nr.05/ I-037 për tatimin mbi vlerën e shtuar

³¹ Deloitte Kosova, Ndryshimet në legjislacionin mbi TVSH, Ruzhdi Zenelaj- prezantim

³² Oda Ekonomike Amerikane, Intervistë me Visar Hapciun, 22 shtator 2016

³³ Gazeta Zyrtare, Ligji nr. 05/L- 037 për tatimin mbi vlerën e shtuar, Neni 28, paragrafi 1.2 dhe 1.7

³⁴ Udhëzim Administrativ nr. 03/2015 për zbatimin e ligjit nr.05/ I-037 për tatimin mbi vlerën e shtuar, Neni 44.1

³⁵ Deloitte Kosova, Ndryshimet në legjislacionin mbi TVSH, Ruzhdi Zenelaj- prezantim

6. Përfundim

Në këtë studim janë analizuar efektet e ndryshimeve në ligjin për TVSH në të hyrat buxhetore, çmimet e konsumit dhe aktivitetin biznesor. Përderisa TVSH është ulur në një numër të vogël produktesh, TVSH prej 18% është vendosur në shumicën e produkteve. Kjo ka reflektuar pozitivisht në të hyrat doganore dhe vendore. Sipas kalkulimeve tona, vetëm nga rritja e TVSH-së, Dogana e Kosovës ka mbledhur mesatarisht rreth 4.5 milionë euro më shumë në muaj në periudhën shtator 2015 - gusht 2016. Më këtë nivel të importit, gjatë vitit 2016 Dogana mund të grumbullojë rreth 54 milionë euro më shumë të hyra vetëm nga rritja e TVSH-së nga 16% në 18%. Përderisa rritja e TVSH-së i ka rritur të hyrat buxhetore, kjo do të thotë që buxhetet e ekonomive familjare janë varfëruar. Për shkak të uljes së çmimeve të importit, rritja e të hyrave buxhetore nuk ka reflektuar në rritjen e çmimeve të konsumit.

Reduktimi i shkallës së TVSH-së në disa produkte ka ndikuar negativisht në të hyrat buxhetore, mirëpo aplikimi i TVSH-së në barna dhe rritja e importit në këto produkte e ka kompensuar këtë humbje. Në anën tjetër, ulja e TVSH-së tek të hyrat vendore duket se ka pasur efekt më të lartë negativ në të hyra. Sa i përket efektit të TVSH-së së reduktuar në çmimet e konsumit, të dhënat sugjerojnë se kjo politikë nuk ka mundur të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e tyre.

Përfaqësues të bizneseve në masë të madhe i kanë përkrahur ndryshimet të cilat kanë ndodhur tek Ligji i ri për TVSH. Largimi i TVSH-së në lëndën e parë dhe makineri prodhuese ka ulur koston fillestare të investimit. Gjithashtu, bizneseve i'u është mundësuar riimbursimi i investimit në makineri prodhuese, gjë e cila është vlerësuar pozitivisht nga bizneset prodhuese.

Ulja e pragut për regjistrim të bizneseve gjithashtu është mirëpritur nga bizneset, për shkak të uljes së informalitetit dhe rrjedhimisht krijimit të parakushteve për një konkurrencë të barabartë në mes të bizneseve. Megjithëse ulja e pragut e ka rritur numrin e bizneseve të regjistruara për TVSH, ATK nuk ka rritur numrin e inspektorëve. Përveç rritjes së inspektorëve, përfaqësues të bizneseve kanë kërkuar rritjen e profesionalizimit të inspektorëve ekzistues.

Së fundmi, përfaqësues të bizneseve e kanë vlerësuar pozitivisht bashkëpunimin që kanë pasur me Qeverinë e Kosovës në procesin e hartimit të Ligjit për TVSH, mirëpo janë të pakënaqur me kohën që kanë pasur në dispozicion për shqyrtim të udhëzimeve administrative. Disa gjëra për të cilat kanë paraqitur vërejte janë: procedurat e rimbursimit, lirimi i TVSH-së nga transaksionet financiare, ngarkesa e kundërt etj.

Duke u bazuar në të gjeturat e cekura më lartë, Instituti GAP rekomandon:

- Krahas uljes së TVSH-së për disa produkte dhe shërbime, Ministria e Financave duhet të paraqesë lehtësime direkte tatimore për qytetarët si masa më efektive për rishpërndarjen e të hyrave;
- Në mënyrë që të sigurohet barazia në treg në mes të bizneseve, ATK duhet të sigurohet që për produkte të njëjta të konsumit, norma e aplikuar e TVSH-së të jete e njëjtë;
- Ministria e Financave të shqyrtojë Udhëzimin Administrativ nr. 03/2015 për zbatimin e ligjit nr.05/ I-037 për tatimin mbi vlerën e shtuar veçanërisht të shkurtohet periudha dhe rishqyrtohen kushtëzimet për rimbursim të TVSH-së;
- Me qëllim të nxitjes së investimeve për kompanitë që mund të marrin kredi nga kompanitë amë, Ministria e Financave duhet të lirojë kompanitë nga TVSH në transaksione financiare;
- Ministria e Financave të fillojë lirimin gradual nga taksa doganore të lëndës së parë duke filluar me lëndët të cilët mund të kenë efekt më të lartë në uljen e kostos së prodhimit. Kjo masë ulë koston e prodhimit për bizneset kosovare dhe i mundëson atyre që të bëhen më konkurrues me produktet e importit;
- Ministria e Financave të fillojë me zbatimin e pushimeve tatimore, si mënyrë për nxitjen investimeve të reja të cilat mund të gjenerojnë vende të reja pune dhe zbusin deficitin tregtar;
- Ministria e Financave duhet të ndajë buxhet për rritje të numrit të inspektorëve për ATK-në, si masë për uljen e informalitetit;
- Në mënyrë që të sigurohet konkurrencë e barabartë në çmimet e teknologjisë informative me çmimet e këtyre produkteve në vendet në rajon, të zgjerohet lista e produkteve të TI-së e përfshirë në listën e produkteve me TVSH të reduktuar;
- ATK duhet të sigurohet që inspektorët kanë aftësitë e duhura dhe njohuritë e mjaftueshme të bazës ligjore, në mënyrë që bizneseve të iu lehtësohet bashkëpunimi me ATK-në. Për këtë arsye, ATK duhet të organizojë trajnime dhe testime të rregullta të stafit.



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Instituti GAP mbështetet nga:

